

Testi i hershëm i dëgjimit

Kind en Gezin ofron një test dëgjimi në javët e para pas lindjes.

- Testi i dëgjimit mund të dallojë defekte të lindura të dëgjimit pak kohë pas lindjes.
- Dallimi i hershëm dhe trajtimi i mëtejshëm i humbjes së dëgjimit është i nevojshëm për zhvillimin e duhur të të folurit dhe gjuhës dhe për t'i ofruar foshnjës tuaj mundësitë më të mira të zhvillimit.
- Testi i dëgjimit është i parrezikshëm, pa dhimbje dhe jashtëzakonisht i besueshëm e do të bëhet nga infermierja e rrethit, mundësisht gjatë javëve të para pas lindjes (ndërmjet 2 dhe 4 javë).

Si bëhet testi i dëgjimit?

Altoparlantë të vegjël do të transmetojnë zhurma të buta në dy veshët e foshnjës tuaj. Pajisja përdor elektroda që ngjiten te koka e fëmijës për të regjistruar ndryshimet në aktivitetin e trurit dhe për të vlerësuar se sa dëgjon foshnja juaj.

Rezultatet do të paraqiten vetëm pas pak minutash. Nëse testi i dëgjimit nuk ofron qartësi të plotë në lidhje me dëgjimin normal, infermierja e rrethit do të caktojë një takim tjetër disa ditë më vonë për të bërë një test tjetër për të kontrolluar dëgjimin. Nëse rezultatet janë negative për herë të dytë, foshnja juaj do të referohet te një qendër që është e specializuar për trajtimin e problemeve të dëgjimit te fëmijët shumë të vegjël. Në këtë mënyrë, do të mësoni shumë shpejt se cili është problemi që ka foshnja juaj dhe mund të filloni çdo trajtim në kohë.

Këshilla për një test dëgjimi pa probleme

- Testi bëhet pa probleme nëse foshnja juaj është e qetë. Ndaj bëni ç'është e mundur për të caktuar një orar kur fëmija juaj fle zakonisht.
- Mos i bëni fëmijës banjë me vajra dhe mos e lyeni me asnjë lloj locioni ose kremi një ditë më parë ose ditën e testit, përndryshe shiriti ngjitës tek elektrodën nuk do të ngjitet siç duhet.
- Vishini foshnjës tuaj rroba të lirshme sepse kjo e bën më të lehtë vendosjen e elektrodave.
- Sigurohuni që foshnja të ketë hëngër pak përpara testit dhe që ju të mund të mund ta ushqeni atë edhe gjatë kohës së testit, nëse është e nevojshme.